



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR SHYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË KOMBËTARE KONSERVATORE ALBANIA, PËR
DORËZIMIN E DOKUMENTAVE PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIDATIT PËR KRYETAR
BASHKIE SHKODËR Z. SHTJEFEN STAKU PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shyrtrimin e kërkesës së partisë Kombëtare Konservatore Albania, për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie Shkodër z. Shtjefen Staku për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "Kombëtare Konservatore Albania" si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia "Kombëtare Konservatore Albania" me vendimin e KQZ-së nr. 40, datë 13.03.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia Kombëtare Konservatore Albania, ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për regjistrimin si kandidat për kryetar bashkie z. Shtjefen Staku.

Me vendimin nr. 537 datë 18.05.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi "Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Shkodër z. Shtjefen Staku, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".



Nr. 643 i Vendimit Data 23.05.2019 Ora 14:30 e Vendimit

Për shyrtrimin e kërkesës së partisë Kombëtare Konservatore Albania, për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Z. Kujtim Gjuzi me cilësinë e kryetarit të partisë "Kombëtare Konservatore Albania", ka depozituar në KQZ dokumentacionin e plotësuar nr. 3521/1 prot., datë 22.05.2019, për regjistrimin për Kryetar të Bashkisë Shkodër z. Shtjefen Staku:

1. Kërkesë për regjistrimin e z. Shtjefen Staku si kandidat për kryetar të Bashkisë Shkodër;
2. Kopje e letërnjoftimit e z. Shtjefen Staku;
3. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Neni 73 pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se: "Dokumentacioni i korigjuar depozitohet jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve" dhe data 19.05.2019 (shtyrë më datë 20.05.2019, pasi data 19.05.2019 ishte ditë e dielë), ishte afati i përcaktuar për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Shkodër z. Shtjefen Staku, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.

Dokumentacioni i depozituar nga kryetari i partisë "Kombëtare Konservatore Albania" është jashtë afatit të përcaktuar në nenin 73 pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga z. Kujtim Gjuzi kryetar i Partisë "Kombëtare Konservatore Albania" është në kundërshtim me pikën 2 të nenit 73 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Refuzimin e kërkesës së Partisë Kombëtare Konservatore Albania për regjistrimin e z. Shtjefen Staku si Kandidat për Kryetar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 643 i Vendimit Data 23.05.2019 Ora 14:30 e Vendimit

Për shyrtimin e kërkesës së partisë Kombëtare Konservatore Albania, për dorëzimin e dokumentave për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019